

V E N D I M
Nr.280, datë 16.7.1996

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në pjesën e Rregullores “Për Kryesinë, komisionet e përhershme e të përkohshme dhe Byronë e Grupit Ndërparlamentar”, neni 8 ndryshohet si vijon:

“Kuvendi Popullor zgjedh këto komisione të përhershme:

1. Komisionin për çështje kushtetuese, ligjore dhe organet e pushtetit lokal, me 9 anëtarë.
2. Komisionin për politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, me 9 anëtarë.
3. Komisionin për ekonominë, buxhetin, financat e privatizimin, me 9 anëtarë.
4. Komisionin për bujqësinë dhe ushqimin, me 7 anëtarë.
5. Komisionin për industrinë, transportin, telekomunikacionin tregtinë, burimet minerare dhe energjetike, me 9 anëtarë.
6. Komisionin për arsimin, shkencën e sportet, me 7 anëtarë.
7. Komisionin për mjetet e informimit publik, me 7 anëtarë.
8. Komisionin për të drejtat e njeriut dhe minoritetin, me 7 anëtarë.
9. Komisionin e kulturës, rinisë e gruas, me 7 anëtarë.
10. Komisionin e shëndetësisë e mbrojtjes së ambientit, me 7 anëtarë.
11. Komisionin e punës, emigracionit e problemeve sociale, me 7 anëtarë.
12. Komisionin e punëve publike, rregullimit të territorit e turizmit, me 9 anëtarë,
13. Komisionin e mbrojtjes, me 9 anëtarë.
14. Komisionin e rendit e SHIK-ut, me 7 anëtarë.
15. Komisionin e mandateve, imunitetit dhe të rregullores, me 7 anëtarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.